



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 21.07.2022

Nr. 39 i vendimit
Datë 25.10.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.10.2022, ditën e martë, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i Rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 532, datë 18.05.2022.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, e cila përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (në vijim Komisioni), deklarimin e procedurës të përfunduar pa një vendim përfundimtar dhe, lidhur me pikën e dytë të dispozitivit të vendimit, mosaplikimin e kufizimit që përcakton humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), ka ushtruar detyrën “Prokuror”, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga data 11.10.2016 deri më datë 30.04.2022. Si prokuror në detyrë dhe që kishte plotësuar deklaratat për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas shtojcave respektive të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim ligji nr. 84/2016), procesi i saj i rivlerësimit i është nënshtruar shortimit të datës 20.07.2020 dhe më pas Komisioni ka nisur veprimtarinë administrative lidhur me të, duke njoftuar edhe subjektin i rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci).
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (në vijim KLP), i ka miratuar subjektit leje të papaguar dyvjeçare më datë 15.01.2020, e cila i përfundonte më 31.01.2022.
3. Më datë 19.11.2020, me kërkesë paraprake, subjekti i rivlerësimit, ka kërkuar shpalljen e moskompetencës lëndore të Komisionit për shkak se nuk e konsideronte që ajo përfshihej në rrethin e subjekteve të parashikuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, në rast të një vendimmarrje të ndryshme nga kërkesa, ka kërkuar afat për plotësimin e formularëve.
4. Subjekti ka depozituar kërkesë për mbarimin e statusit, duke dhënë dorëheqjen nga detyra më datë 07.03.2022 dhe më datë 18.03.2022, KLP-ja, me vendimin nr. 50, datë 18.03.2022, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, ka miratuar dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit. Statusin e magjistratit znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) e ka humbur më datë 30.04.2022

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, pasi ka administruar Vendimin e KLP-së nr. 50, datë 18.03.2022, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, nëpërmjet të cilit është miratuar dorëheqja nga detyra e znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe ka hetuar rreth tij, ka konkluduar:

5.1 Subjekti ka depozituar kërkesë për mbarimin e statusit dhe ka dhënë dorëheqjen nga detyra/statusi më datë 07.03.2022 dhe më datë 18.03.2022, KLP-ja, me vendimin nr. 50, datë 18.03.2022, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, ka miratuar dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit. Statusin e magjistratit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), e ka humbur më datë 30.04.2022.

5.2 Komisioni, pasi është njohur me vendimin e KLP-së, ka kryer hetimin për dorëheqjen, duke konstatuar, përveç të tjerave, që ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim dhe me vendimin nr. {***}, datë 05.05.2022, “Për mbylljen e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit znj. Esmeralda Ndoci”, ka vendosur mbylljen e hetimit për rivlerësimin dhe kalimin në seancë dëgjimore.

5.3 Komisioni ka ftuar subjektin për pjesëmarrje në seancën dëgjimore dhe kësaj ftese përfaqësuesja ligjore e subjektit i është përgjigjur pozitivisht, duke marrë pjesë në seancën e datës 16.05.2022.

5.4 Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), me vendimin nr. 532, datë 18.05.2022.

6. Për sa më lartë, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni ka vendosur:

1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*
2. *Ndalimin e emërimit të subjektit Esmeralda Ndoci si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
3. *Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
4. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.*

III. Shkaqet e ankimit

7. Më datë 30.06.2022, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim, kundër vendimit të Komisionit nr. 532, datë 18.05.2022, me shkaqet, në mënyrë të përmbledhur:

7.1 Në Kolegj, nëpërmjet parashtrimeve dërguar më datë 14.10.2022, subjekti kërkoi prishjen e vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit dhe deklarin e procedurës të përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi procesi i rivlerësimit i nisur ndaj saj është një proces që nuk mund të niste, e meqë ka nisur nuk mund të vijojë, për shkak se i mungon cilësia e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

7.2 Lidhur me pikën e dytë të dispozitivit të vendimit të Komisionit, subjekti ka kërkuar mosaplikimin e kufizimit që përcakton humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Subjekti ka pretenduar që kjo pikë e dispozitivit të vendimit nuk mund të aplikohet ndaj saj, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, (në vijim ligji nr. 76/2016) dhe të ligjit nr. 84/2016, nuk ishte e emëruar në detyrë dhe nuk gëzonte statusin e

magjistratit, si edhe për faktin që aplikimi i saj vjen si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor për shkak të shkeljes së neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, (në vijim “Kolegji”), ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet (*ratione personae*) të paraqesë ankim ndaj vendimeve të Komisionit, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Ankimi është ushtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe në bazë të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit, kryhet nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Duke qenë se çështja nr. 34/2022, datë 21.07.2022, ka për objekt ankimin ndaj një vendimi të Komisionit që ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, në bazë të nenit 20, pika 1/2 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, kjo çështje është shqyrtuar me procedurë të përsheptuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

12. Në analizë të shkaqeve të ankimit, Kolegji çmoi se para tij shtroheshin për zgjidhje kryesisht dy çështje në përmbledhje të tyre, të renditura si më poshtë.
 1. Nëse ankuesja Esmeralda Maillard (Ndoci) gëzonte statusin e magjistratit në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016.
 2. Nëse është ankuesja subjekt rivlerësimi, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 dhe a është vlerësimi i saj një çështje që hyn në juridiksionin e organeve të rivlerësimit.

13. Lidhur me çështjen e parë, Kolegji mori në analizë rrethanat e faktit që rezultojnë të provuara në rastin konkret në kontekstin e legjislacionit të zbatueshëm, për t'i dhënë përgjigje çështjes nëse ankuesja e kishte fituar ose jo statusin e magjistratit me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 76/2016.
14. Rezulton se në vitin 2013, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) është kualifikuar për të ndjekur programin 3-vjeçar të formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin Prokuror për periudhën 2013-2016. Pas përfundimit të vitit të dytë të formimit fillestar, në vitin 2015, në bazë të nenit 23 të ligjit nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar, dhe të nenit 19 të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i shfuqizuar, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9221, datë 07.09.2015, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) është caktuar për të ndjekur stazhin profesional në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pas kryerjes së stazhit profesional në këtë prokurori, që përkon me përfundimin e programit 3-vjeçar të formimit fillestar dhe pas vlerësimit të kryer nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, referuar ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, i shfuqizuar, me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 9757, datë 11.10.2016, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) është emëruar në detyrë si “Prokuror” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Rezulton se emërimi i saj në këtë detyrë është bërë mbi propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm të datës 10.10.2016.
15. Në analizë të datave të cituara më lart, evidentohet se ankuesja është emëruar në detyrën e prokurorit në datën 11.10.2016. Emërimi i saj ka ndodhur në një kuadër ligjor të ri, i cili edhe pse u përgatit në paketën e përbashkët të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë, nuk u arrit që të miratohej si i tillë në mënyrë harmonike në të njëjtën kohë. Ky handicap solli efekte për sa i përket kohës së hyrjes në fuqi të ligjeve në kohë të ndryshme, në mënyrë të sfuzuar nga njëri-tjetri, e duke sjellë si pasojë edhe humbjen e relevancës që do të kishte miratimi i njëkohshëm i tyre. Kështu, rezulton se në kohën e daljes së Dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, datë 11.10.2016, kishte hyrë në fuqi ligji nr. 76/2016 në datën 11.08.2016 dhe ligji nr. 84/2016 në datën 08.10.2016. Ndërsa rezulton se ka qenë miratuar në Kuvendin e Shqipërisë ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në datën 06.10.2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 22.11.2016, (në vijim ligji nr. 96/2016). Krahas këtij legjislacioni që konsiderohet relevant për t'i dhënë përgjigje çështjes së shtruar për zgjidhje, konstatohet se ishin ende në fuqi ligji nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim ligji nr. 8136/1996), i cili u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, (në vijim ligji nr. 115/2016) në datën 16.12.2016. Gjithashtu, ishte në fuqi ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim ligji nr. 8737/2001) deri më datë 22.11.2016.
16. Nën optikën e kuadrit ligjor të përshkruar më lart, Kolegji mori në analizë faktet që rezultojnë nga aktet në fashikull.
17. Lidhur me çështjen e parë, konstatohet se hyrja në fuqi e ligjit nr. 76/2016, i cili miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në datën 11.08.2016, e gjeti ankuesen Esmeralda Maillard (Ndoci) në përfundim të periudhës së stazhit profesional, që përfaqësonte edhe vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës të kryer në përputhje me nenin 14, paragrafi 1, germa “c”¹ dhe nenin

[¹] c) Një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

19 të ligjit nr. 8136/1996² dhe përkonte, gjithashtu, me marrjen e vlerësimit për këtë vit nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, në përputhje me nenin 9, pika 2, germa “e”³ dhe nenin 20 të po këtij ligji⁴.

18. Përgjatë gjithë përmbajtjes së ligjit nr. 8136/1996, individët që ndjekin studimet në këtë shkollë janë të titulluar si “kandidatë për magjistratë”, duke filluar me përmbajtjen e nenit 1 dhe deri në nenin 21 të tij. Në nenin 22⁵ parashikohet sanksioni për magjistratët e emëruar, të cilët nuk pranojnë të ushtrojnë funksionet në vendin e emërimit, ligji ndryshon terminologjinë për kualifikimin e tyre nga “kandidatë për magjistratë” në “magjistratë”. Kjo dispozitë e ligjit e lidh fitimin e këtij titulli me emërimin e tyre, duke bërë një dallim të qartë mes statusit të tyre si “kandidatë për magjistratë” deri në fund të stazhit profesional dhe në “magjistratë” vetëm pas emërimit që kryhet pas mbarimit të këtij stazhi, në përfundim të studimeve të plota në këtë shkollë.
19. Krahas analizës së dispozitave të ligjit nr. 8136/1996, Kolegji analizoi edhe dispozitat e ligjit nr. 8737/2001, sipas të cilave dallohet sërish diferenca që ligji bën për cilësimin e të emëruarve në detyrë si “prokurorë” dhe atyre të emëruar në stazhin profesional, sipas nenit 23 të ligjit⁶ si “prokurorë në stazh”. Sipas përmbajtjes së këtyre dispozitave, statusi i këtyre dy kategorive, nuk konsiderohet i barabartë.
20. Dispozitat e mësipërme, të cilat kanë qenë formalisht në fuqi në kohën e miratimit të ndryshimeve kushtetuese, por që u shfuqizuan shpejt në kohë pas ndryshimeve kushtetuese me ligjet nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të gjithë ligjet që bënin pjesë në paketën e ligjeve që u miratuan në kuadër të reformës në drejtësi, nuk konstatohet se bëjnë ndonjë diferencë thelbësore edhe në këndvështrim të parashikimeve që këto ligje kanë për statusin e individëve/të kualifikuar që ndjekin Shkollën e Magjistraturës dhe fitimin më pas të statusit të magjistratit. Ligji nr. 96/2016 i konsideron të kualifikuarit/studentët që ndjekin Shkollën e Magjistraturës si “kandidatë për magjistratë” dhe në nenin 33 të tij parashikon rregullat për praktikën/stazhin profesional, si për kandidatët gjyqtarë dhe prokurorë. Ata konsiderohen sërish si kandidatë magjistratë, sipas nenit 34 të ligjit, edhe pasi janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës,

[²] Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magjistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

[³] e) Bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të Formimit Fillestar, mbi bazën e rezultateve të arritura gjatë periudhës dyvjeçare të vitit teorik dhe stazhit paraprofesional dhe në përfundim të stazhit profesional.

[⁴] Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit. Me kërkesë të Drejtorit të Shkollës, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku zhvillohet stazhi, caktojnë gjyqtarë ose prokurorë, të cilët, pasi kontrollojnë punën e stazhierit, paraqesin raporte vlerësimi për të. Drejtoria e shkollës i dërgon Presidentit të Republikës të dhënat e procesit të vlerësimit për të bërë emërimin përfundimtar të tyre në vendet vakante, në përputhje me shkollën e vlerësimit të tyre nga shkolla, pas propozimeve të bëra, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjyqtarët dhe nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët.

[⁵] Magjistratët e emëruar që, pa shkaqe të përligjura, nuk paraqiten në detyrë, heqin dorë apo kërkojnë largimin nga detyra, pa kaluar 5 vjet nga emërimi i tyre, detyrohen t'i kthejnë Shkollës së Magjistraturës shpërblimin që kanë marrë gjatë periudhës së parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 14 të këtij ligji, në proporcion me kohën e mospërmbushjes së detyrimit.

[⁶] 1. Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi.

duke marrë titullin “magjistrat” vetëm pas emërimit të tyre, pasi diplomohen në përputhje me kushtet e procedurat e nenit 35 të ligjit. Sjellja në vëmendje e dispozitave të reja, bëhet nga Kolegji në funksion të potencimit të idesë se pavarësisht ndryshimit të bazës kushtetuese mbi të cilat janë miratuar këto dispozita, ato që ishin në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, por edhe ato që u miratuan pas tyre, kanë demonstruar qartë qëllimin e kushtetutbërësit dhe ligjbërësit, se statusi i individëve/të kualifikuar që ndjekin Shkollën e Magjistraturës dhe atyre që emërohen në detyrë pas përfundimit të saj nuk është i njëjtë.

21. Statusi i studentëve/të kualifikuarve të Shkollës së Magjistraturës, mbetet ai i “kandidatit për magjistrat”, përderisa, në përfundim të studimeve në shkollë ai nuk ka marrë ende vlerësimin përfundimtar të Këshillit Pedagogjik dhe nuk është diplomuar. Qenia e tyre si kandidatë për magjistrat, në terma ligjorë jo gjithmonë do të nënkuptojë domosdoshmërisht fitimin edhe të statusit të magjistratit. Ky status fitohet vetëm pas përfundimit me sukses të Shkollës së Magjistraturës dhe emërimit në një pozicion nga organet përkatëse.
22. Në vijim të sa më sipër, rezulton se në kohën e emërimit të ankueses në funksionin e prokurores, me Dekretin e Presidentit të Republikës, datë 11.10.2016, kishin hyrë në fuqi ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016. Sipas nenit 148/ç të Kushtetutës i cili parashikon se: *“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj”*, një shtetas shqiptar mund të emërohej prokuror vetëm pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak. Organi kompetent, sipas kësaj norme Kushtetuese për emërimin e prokurorëve, ishte Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili nuk ishte krijuar ende në kohën e emërimit të ankueses⁷. Në këtë periudhë tranzitore, kur norma kushtetuese kishte pësuar ndryshime, të cilat ishin ende të paaplikueshme për shkak të mosngritjes ende të institucioneve të reja të drejtësisë, një realitet i jetuar dhe i njohur edhe për Kolegjin, organet e mëparshme kushtetuese vijuan, në zbatim të parim të kontinuitetit, me ushtrimin e kompetencave të tyre të mëparshme, në kuadrin e ri ligjor, parim i cili u konfirmua më pas në kohë edhe me miratimin e ligjit nr. 96/2016, i cili përcaktoi qartazi se cilët ishin organet që do të ushtronin përkohësisht kompetencat e organeve të reja që nuk ishin krijuar ende. Neni 160 i ligjit nr. 96/2016 përcaktoi se Prokurori i Përgjithshëm ushtronte disa nga funksionet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në krijimin e këtij të fundit.
23. Në vlerësimin e Kolegjit, momenti i emërimit të ankueses si prokurore, me Dekretin e Presidentit të Republikës në datën 11.10.2016, është edhe momenti kur ajo ka fituar statusin e magjistratit, sipas dispozitave të ligjit nr. 8136/1996 dhe ligjit nr. 8737/2001.
24. Në konkluzion të arsytimit të mësipërm, Kolegji çmon se ankuesja nuk e ka pasur statusin e magjistratit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi e ka fituar atë pas hyrjes në fuqi të tyre.
25. Lidhur me çështjen e dytë, Kolegji mori në shqyrtim rrethanat e faktit që i referoheshin ushtrimit faktik të funksionit të prokurores. Duke qenë se ankuesja, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, kishte statusin e “kandidatit për magjistrat”, në zbatim të nenit 14, paragrafi 1, germa “c” e ligjit nr. 8136/1996 kishte ushtruar për një periudhë kohe, tetor 2015 – qershor 2016, funksionet e prokurores, në funksion të kryerjes së stazhit profesional, rrethana të cilat

[⁷] Mbledhja e parë që ka konstituuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë daton më 19.12.2018. Konstituimi është bërë me vendimin nr. 1, datë 19.12.2018, “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë” (marrë nga faqja zyrtare e KLP-së).

ishin vlerësuar prej Komisionit se plotësonin kushtet e nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe e kualifikonin atë si subjekt rivlerësimi. Kolegji analizoi këto rrethana në raport me dispozitat ligjore në fuqi në kohë dhe i lexoi/interprettoi ato sipas një interpretimi historik, logjik e në kuptim të qëllimit të ligjit.

26. Në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës është përcaktuar rrethi i subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe janë përfshirë të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*, ndërsa në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 është përcaktuar që subjekt rivlerësimi, sipas këtij ligji, janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës.
27. Në mënyrë që të interpretohet parashikimi kushtetues “të gjithë prokurorët”, Kolegji mori në konsideratë konkluzionin e arritur më lart se ankuesja, në kohën e hyrjes në fuqi të dispozitës kushtetuese që përcakton rrethin e personave që do t’i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, nuk e kishte fituar statusin e magjistrates/prokurores, por gëzonte vetëm statusin e kandidatës për magjistrate, rrethanë e cila, nuk i jep asaj, në vlerësimin e Kolegjit, titullin e prokurores në kuptim të këtij parashikimi.
28. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji mori në shqyrtim faktin nëse ushtrimi i funksioneve të prokurorit përgjatë e periudhës prej nëntë muajsh gjatë kryerjes së stazhit profesional i jepte ankueses cilësinë e prokurores në kuptim të dispozitës kushtetuese. Në vështrim të kontekstit historik të miratimit të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se nevoja për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe këtij procesi të jashtëzakonshëm kontrolli e vlerësimi për magjistratët, kishte lindur për shkak të korrupsionit endemik të pranuar si nga faktori i brendshëm edhe i jashtëm në sistemin e drejtësisë në vend. Procesi i rivlerësimit u miratua në frymën dhe synimin për të nxjerrë nga sistemi individë, të cilët, për shkak të nivelit të pabesueshëm në justifikimin e pasurisë, në kontrollin e figurës apo të aftësive profesionale, kishin cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ky proces u konsiderua nga kushtetutbërësi, si i vetmi dhe i justifikueshëm për të mundësuar spastrimin e radhëve të sistemit të drejtësisë.
29. Ankuesja rezulton të jetë bërë pjesë e këtij sistemi me emërimin në detyrë me Dekretin e Presidentit të Republikës, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dhe ushtrimi i funksioneve të prokurorit prej saj përgjatë periudhës së stazhit ka qenë një detyrim që vinte prej qenies si kandidate në Shkollën e Magjistraturës, e për më shumë, si një vit praktik i përvetësimit të njohurive të duhura për t’u diplomuar dhe marrë titullin e magjistratit. Ushtrimi i funksioneve përgjatë këtij viti, jo vetëm që nuk justifikojn shqetësimin e kushtetutbërësit për individët që kishin cenuar besimin e publikut, për shkak të kohës së shkurtër brenda së cilës ato janë ushtruar, por edhe nuk mund të konsiderohen se janë ushtruar në kryerje të detyrës së prokurorit, por brenda një programi akademik të strukturuar dhe konceptuar në mënyrë të tillë nga vetë ligji nr. 8136/1996. Moskryerja në mënyrën e duhur të detyrave të prokurorit stazhier përgjatë kësaj periudhe mund të ndëshkohej në kuptim të ligjit me një vlerësim negativ të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, me pasojë mosdiplomimin e saj. Vetëm pas emërimit me Dekretin e Presidentit të Republikës dhe betimit, sipas parashikimit të nenit 22 të ligjit nr. 8737/2001⁸, prokurorët konsiderohen se fillojnë detyrën e tyre në kuptim të ligjit.

[⁸] Para fillimit të detyrës, prokurorët bëjnë betimin si vijon: “Betohej solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të ruaj të pastër figurën e prokurorit. Betohej!”.

30. Në mbështetje të këtij arsyetimi vjen edhe parashikimi i nenit 160 i ligjit nr. 96/2016, i cili me një rregullim tranzitor ka marrë përsipër, jo vetëm të përcaktojë se cilat janë modalitetet e trajtimit të grupit të magistratëve të diplomuar në vitin 2016, por ndihmon edhe në interpretimin logjik që i bëhet nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës. Sipas nenit 160, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *“Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj: a) emëron magistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magistratë të diplomuar në vitin 84 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”*, vërehet se kjo dispozitë ka marrë përsipër të rregullojë në mënyrë posaçme, emërimin në detyrë dhe caktimin në pozicione të kandidatëve për magistratë të diplomuar në vitin 2016, në të cilët përfshihet edhe ankuesja, duke referuar edhe dispozitat që duhen zbatuar për kontrollin e tyre para emërimit në detyrë në pjesën III, Kreu II dhe III i ligjit nr. 96/2016. Ky parashikim ligjor tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që ky grup kandidatësh t’i nënshtroheshin kontrollit, sipas juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 para se ata të emëroheshin në detyrë, ashtu siç edhe është parashikuar për brezat e ardhshëm të kandidatëve për magistratë. Në këtë dritë, ndërsa ligjvënësi ka pasur për qëllim që këta magistratë t’i nënshtroheshin juridiksionit të përgjithshëm, ai nuk mund të ketë pasur për qëllim t’i përfshijë ata në grupin e subjekteve të rivlerësimit që do t’i nënshtroheshin kontrollit, sipas juridiksionit të posaçëm të rivlerësimit, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke vendosur vetëm për këtë grupim një kontroll të dyfishtë. Kryerja ose jo e këtij kontrolli nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka emëruar në detyrë ankuesen, në zbatim të dispozitave tranzitore, nuk është një çështje, e cila mund të ndikojë në qëndrimin ligjor që Kolegji duhet të mbajë mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 179/b të Kushtetutës.
31. Në përmbledhje të sa më lart, Kolegji vlerëson se fakti që ankuesja ka kryer detyrat e prokurorit në periudhën e stazhit profesional nën mbikëqyrjen e një prokurori në detyrë, apo parashikimi ligjor i nenit 21⁹ të ligjit nr. 8136/1996, sipas të cilit kandidatët për magistratë gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime si magistratët gjatë periudhës së stazhit, duhen çmuar në raport me dispozitat e reja që rregullojnë në mënyrë të posaçme statusin dhe kontrollin e këtij grupi magistratësh. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se rregullimi i posaçëm për grupin e magistratëve që janë diplomuar në vitin 2016 merr përparësi në raport me situatën e përgjithshme juridike që i takonte të gjithë magistratëve të diplomuar në vite, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8136/1996 dhe jashtë kontekstit të zbatimit të paketës së reformës në drejtësi. Për më tepër, juridiksioni i rivlerësimit është një rregullim i jashtëzakonshëm që shoqërohet me kufizime të disa të drejtave themelore, sipas përcaktimeve të Nenit A të Aneksit të Kushtetutës, rrethanë e cila në vlerësimin e Kolegjit, detyron një interpretim strikt të dispozitës dhe jo të zgjeruar, interpretim i cili mund të cenojë përtej qëllimit të ligjit të drejtat dhe liritë themelore të ankueses dhe të mos garantojë një proces të rregullt ligjor në kuptim të neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së.
32. Fakti që ankuesja ka depozituar deklaratat, sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e Kolegjit nuk mund të afektojë interpretimin që i bëhet nenit 179/b të Kushtetutës, interpretim i cili lidhet me vullnetin e ligjvënësit dhe jo me sjelljen procedurale të subjekteve. Për më tepër, duket e arsyeshme që ankuesja, në kushtet e një paqartësie ligjore për mënyrën se si do të interpretohej dispozita dhe statusi i saj, ka marrë masat që ajo mos të ndëshkohet për shkak të një paqartësie/ambiguiteti ligjor, veçanërisht në kohën e dorëzimit të deklaratave, por edhe më pas. Sidoqoftë, kjo rrethanë nuk mund të konsiderohet se përfshin në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen

[⁹] Gjatë periudhës së stazhit profesional kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njëloj si magistratët.

rivlerësimi kalimtar ankuesen, përfshirje e cila mbetet, gjithsesi, një çështje ligjore dhe e pa afektuar nga vullneti i palëve në proces.

33. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se ankuesja nuk është një subjekt, i cili duhet të nënshtrohet *ex officio* procesit të rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.
34. Duke pasur në konsideratë këto konkluzione, Kolegji çmon se kontrolli dhe vlerësimi i ankueses, nuk është një proces që duhet t'i nënshtrohet parashikimeve për procesin e rivlerësimi, por ajo i takonte juridiksionit të zakonshëm, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mungesë të juridiksionit të rivlerësimi ndaj ankueses, veprimtaria e Komisionit, si një prej organeve të rivlerësimi, është kryer në tejkalim të juridiksionit të tij kushtetues e ligjor dhe, për pasojë, disponimet e bëra prej tij në vendim duhet të mbeten pa fuqi ligjore dhe të mos kenë efekt mbi karrierën e mëtejshme të magistrates, e cila duhet t'i nënshtrohet rregullave të legjislacionit të përgjithshëm edhe për këtë pjesë.
35. Në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji çmon se Komisioni ka vepruar në tejkalim të juridiksionit të tij rivlerësues, kur ia ka nënshtrohet ankuesen procesit të rivlerësimi. Në këto kushte, vendimi i Komisionit, i dhënë në mungesë të juridiksionit të tij dhe pa pasur për pasojë as kompetencë lëndore për të vendosur për kontrollin e ankueses, është një vendim i marrë në tejkalim të ligjit dhe, si tillë, duhet të priset.
36. Kolegji, duke konkluduar për mungesën e juridiksionit rivlerësues të Komisionit në rastin konkret, vlerësoi se neni 66 i ligjit nr. 84/2016, për mënyrën e dispononimit të Kolegjit, mbetet pa efekt dhe, për këtë arsye, në referim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, thirri për zbatim dispozitat e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe parashikimi i nenit 50 germa “d” e tij, u gjet si dispozita që rregullon zgjidhjen e çështjes në fjalë.
37. Për sa më sipër, trajtimi i pretendimeve të tjera të subjektit, që lidhen me procesin e rregullt dhe proporcionalitetin e masës ndaluese, u konsideruan prej Kolegjit pa relevancë dhe të panevojshme për trajtim, duke qenë se vendimi i Komisionit, vlerësohet se duhet të priset për mungesën e juridiksionit të organit.
38. Përfundimisht, Kolegji arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit nr. 532, datë 18.05.2022, duhet të priset për sa kohë është marrë nga një organ në tejkalim të kompetencës së tij lëndore, për shkak të mungesës së juridiksionit për trajtimin e çështjes dhe gjykimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit duhet të pushohet, në zbatim të nenit 50, germa “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 50, germa “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 532, datë 18.05.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) dhe pushimin e gjykimit të çështjes.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall në Tiranë, më datë 25.10.2022.

ANËTARE

ANËTAR

ANËTARE

Albana SHTYLLA

Sokol ÇOMO

Mimoza TASI

nënshkrimi

nënshkrimi - kundër

nënshkrimi

RELATORE

KRYESUESE

Ina RAMA

Natasha MULAJ

nënshkrimi

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 39 (JR), datë 25.10.2022, me të cilin është vendosur prishja e vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) dhe pushimi i gjykimit të çështjes.
2. Komisioni, me vendimin nr. 532, datë 18.05.2022, ka vendosur: *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Esmeralda Ndoci, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndalimin e emërimit të subjektit Esmeralda Ndoci, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].*
3. Nëpërmjet ankimit të ushtruar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), ka kërkuar ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi, me pretendimin se Komisioni nuk kishte kompetencë lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi objekti për të cilën kishte nisur procesi apo qëllimi i tij ishte i pamundur. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk kishte statusin e magjistratit, por të kandidatit për magjistrat, duke iu referuar momentit të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, datë 08.10.2016, me emërimin e saj si magjistrate, më datë 11.10.2016.
4. Unë, gjyqtare në pakicë, çmoj se konkluzioni i shumicës, lidhur me dy çështjet e marra nën analizë: (i) nëse ankuesja gëzonte statusin e magjistratit në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016; dhe (ii) nëse është subjekt rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 dhe a është vlerësimi i saj një çështje që hyn në juridiksionin e organeve të rivlerësimit, është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin e posaçëm të këtij procesi, vlerësuar në raport me situatën faktike dhe aktet e administruara në dosjen gjyqësore, që i kanë shërbyer gjykimit të kësaj çështjeje, më konkretisht:

I.

5. Ashtu siç është trajtuar në vendimin e Komisionit znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) është subjekt rivlerësimi, sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjit dhe, për arsyet e parashtruara në vijim, duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit si të gjithë magjistratët e tjerë.
 - 5.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), me Dekretin nr. 9221, datë 07.09.2015, e Presidentit të Republikës, është emëruar *prokurore në stazh* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërsa me Dekretin nr. 9757, datë 11.10.2016, e Presidentit është emëruar *prokurore* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi kishte hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 08.10.2016.
 - 5.2. Referuar Dekretit nr. 9221, datë 07.09.2015, të Presidentit të Republikës, i cili është mbështetur në kompetencat që i jep Kushtetuta dhe ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 23, pika 1 të tij, shprehet se: “Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës emëron prokurorë në stazh personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, për të kryer

stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 'Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë', në prokuroritë pranë gjykatave që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi”.

5.3. Në kuptim të kësaj dispozite, e cila të orienton në mënyrë të drejtpërdrejtë në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, ligj i cili ka qenë në fuqi në momentin e emërimit si prokurore në stazh të subjektit të rivlerësimit, i cili në nenin 21 të tij, përcakton se: “Gjatë periudhës së stazhit profesional kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njëjloj si magjistratët”. Sipas kësaj dispozite, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) ka ushtruar detyrën e prokurores si të gjithë magjistratët e tjerë, fakt që gjen reflektim edhe në librezën e saj të punës, ku gjatë periudhës së stazhit figuron si “Prokurore”, po kështu gjatë kësaj periudhe ka kryer veprime hetimore, ka marrë vendime të cilat janë të ankimueshme, ka përfaqësuar organin e akuzës në çështje të ndryshme në gjykatë, ka përfituar pagë të njëjtë me magjistratët e tjerë, duke qenë e barabartë me ta. Për analogji, i referohemi këtu edhe kandidatit për gjyqtar që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pa asnjë kufizim me gjyqtarët e tjerë, duke arsyetuar e nënshkruar vendime në *Emër të Republikës*.

5.4. Faktin që znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) gëzon të drejtat dhe detyrimet e statusit të magjistratit e përforcon dhe përmbushja prej saj e detyrimit për të depozituar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë për periudhën 2015-2016, kur ishte duke kryer stazhin, po ashtu edhe depozitimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe deklaratave periodike vjetore në vitet pasardhëse. Natyrshëm në këtë rast të lind pyetja përse, pikërisht, pasi kishte filluar procesi i rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci) kujtohet të kërkojë që mos t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, në një kohë kur vetë ajo ka vlerësuar të paraqesë deklaratën pranë ILDKPKI-së, duke shprehur kështu vullnetin për t’u rivlerësuar, pa ngritur dyshimin se në atë periudhë nuk i përkiste kategorisë së parashikuar nga neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës.

II.

6. Referuar akteve të dosjes, rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 7.03.2022, ka paraqitur para Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën për heqjen dorë nga detyra e magjistratit për të jetuar jashtë vendit pranë bashkëshortit dhe vazhduar jetën familjare. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kërkesën e subjektit, me vendimin nr. 50, datë 18.3.2022, ka vendosur “*Mbarimin e statusit të magjistratit*”, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të dorëheqjes së saj. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit Esmeralda Maillard (Ndoci). Vendim i cili nuk është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit, duke pranuar kështu disponimin e KLP-së mbështetur në dorëheqjen e magjistratit.

6.1. Në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, ku shprehimisht parashikohet se: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*”, në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, vlerësoj se mbarimi i statusit të magjistratit, si pasojë e heqjes dorë nga detyra, në mënyrë direkte afekton humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit për efekt të këtij procesi e që pashmangshmërisht kërkon aplikimin e nenit G, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës. Në kushtet e qartësisë së kësaj dispozite çmoj të drejtë vendimmarrjen e Komisionit, pasi si Kushtetuta, ashtu

edhe ligji nuk i kanë lënë organeve të rivlerësimit opsion tjetër disponimi përveç aplikimit të këtij neni në rastet e dorëheqjes gjatë procesit të rivlerësimit.

6.2. Pretendimi i subjektit në ankim se nuk ka qëllim shmangien nga procesi i rivlerësimit, por dorëheqjen nga detyra për shkak të kushteve familjare, nuk është bindës, për vetë faktin se subjekti i rivlerësimit mund të vijonte këtë proces, nëpërmjet përfaqësueses së saj ligjore, caktuar me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.08.2021, të cilës i delegon të gjitha të drejtat, që lidhen me procesin deri në finalizimin e tij, të tilla si: (i) për ta përfaqësuar në mungesë të saj, në seancat që do të zhvillohen pranë Komisioni, lidhur me rezultatet e hetimit, për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) ta përfaqësojë në Komision dhe Kolegj, duke i dhënë të drejta që të përpilojë, të nënshkruajë në emër të saj ankime ndaj çdo vendimmarrje apo akti procedural të Komisionit dhe Kolegjit, në rast se ato vijnë në kundërshtim me interesat e saj; (iii) që t'u drejtohet organeve të administratës, bankave të nivelit të dytë, ILDKPKI-së për marrjen e dokumenteve të nevojshëm, informacioneve në emër të saj e për t'i paraqitur në proces.

6.3. Për arsyet më sipër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit me vullnetin e saj të lirë ka hequr dorë nga procesi i rivlerësimit, duke i pasur të gjitha mundësitë për ta përfunduar atë me vendimmarrje përfundimtare e duke treguar kështu gatishmëri për të konkluduar këtë proces kaq të rëndësishëm të reformës në drejtësi. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka vendosur ndërprerjen dhe ndalimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci), për emërimin e saj, *gjqytar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

7. Për sa sipër arsyetuar, vlerësoj se Komisioni nuk ka vepruar në tejkallim të juridiksionit rivlerësues të tij për rastin objekt shqyrtimi dhe as të mungesës së kompetencës lëndore dhe, për rrjedhojë, shumica e trupit gjykues në mënyrë të gabuar ka disponuar me vendimmarrjen për pushimin e gjykimit në tejkallim të parashikimeve të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, i cili në mënyrë eksplicite ka përcaktuar vendimmarrjet e mundshme të Kolegjit, të cilat janë: (i) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; (ii) ndryshimin e vendimit të Komisionit; dhe (iii) prishjen e vendimit të Komisionit. E që në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji duhet të vendoste lënien në fuqi të vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Maillard (Ndoci).

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë anëtari i trupit gjykues Sokol Çomo, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 532, datë 18.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Esmeralda Maillard (Ndoci).
2. Për sa i përket konstatimit të fakteve juridike, që kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes, jam dakord me shumicën, por kam një qëndrim të kundërt për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe legjislacionit, që përbën paketën ligjore të reformës në drejtësi, të miratuar pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016. Interpretimi im i nenit 179/b të Kushtetutës bëhet në harmoni me nenin 148/ç të Kushtetutës, i cili parashikon se *prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe figurës së tyre sipas ligjit.*
3. Emërimi i subjektit të rivlerësimit Esmeralda Maillard (Ndoci), *si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9757, datë 11.10.2016, rezulton të jetë bërë në bazë të nenit 23, pika 3 e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Nga gjykimi në Kolegj nuk rezultoi që në momentin e emërimit të ankueses të jetë kryer ndonjë proces *verifikimi paraprak* i pasurisë dhe i figurës, duke bërë që emërimi i saj si prokurore të vinte në kundërshtim të hapur me urdhërimin e nenit 148/ç të Kushtetutës.
4. Në këto kushte, vlerësoj se interpretimi që Kolegji duhet t’i bënte zbatimit të nenit 179/b të Kushtetutës në çështjen konkrete nuk duhet të ishte literal, por sistematik në frymën e ndryshimeve kushtetuese dhe parashikimeve të paketës ligjore të vitit 2016, për implementimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese, si dhe parashikimet ligjore të kësaj pakete kërkojnë që asnjë magjistrat të mos ushtrojë detyrën pa iu nënshtroar verifikimit të pasurisë dhe figurës. Në vlerësimin tim është i pajustificueshëm interpretimi që ka bërë shumica se subjekti i rivlerësimit Esmeralda Maillard (Ndoci) nuk duhej t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar.
5. Arsyetimin e saj, në mbështetje të konkluzionit të mësipërm, shumica e ka ngritur mbi trajtimin e dy çështjeve, të cilat i ka konsideruar thelbësore për zgjidhjen e çështjes, si më poshtë:
 - a. *Nëse ankuesja Esmeralda Maillard (Ndoci), gëzonte statusin e magjistratit në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016?*
 - b. *Nëse ankuesja është subjekt rivlerësimi, sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, a është vlerësimi i saj një çështje që hyn në juridiksionin e organeve të rivlerësimit?*

6. Në vlerësimin tim, për efekt të parashikimit të nenit 21 të ligjit 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së stazhit profesional në vitin 2016 gëzonte të drejta dhe kishte detyrime njësoj si magjistratët. Këto të drejta dhe detyrime janë gëzuar dhe duhet të përmbusheshin nga subjekti i rivlerësimit deri në momentin e paraqitjes së dorëheqjes nga funksioni i prokurorit.
7. Me hyrjen në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të gjithë magjistratët në detyrë duhet t’i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*. Subjekti i rivlerësimit ka gëzuar të gjitha të drejtat e magjistratit gjatë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe pas përfundimit të saj, por në të njëjtën kohë ajo duhet të përmbushte edhe të gjitha detyrimet që kishin magjistratët në detyrë. Në kuadër të këtyre detyrimeve rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë plotësuar formularët e parashikuar në shtojcat e ligjit nr. 84/2016, duke treguar në këtë mënyrë se e njëjta detyrimin për t’ju nënshtroar procesit të rivlerësimit kalimtar nga institucionet e rivlerësimit.
8. Në kushtet kur ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e emërimit të subjektit të rivlerësimit si prokuror, nuk kishte hyrë në fuqi dhe, për pasojë, emërimi i saj nuk ishte bërë sipas parashikimeve të këtij ligji e konsideroj jo relevante analizën që shumica e trupit gjykues i ka bërë parashikimeve të tij, në funksion të arsyetimit të vendimit të saj.
9. Emërimi i subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet kushtetuese të nenit 148/ç, sa i takon mungesës së verifikimit të ankueses për pasurinë dhe figurën, në gjykimin tim dikton një interpretim sistematik të kuptimit të zgjeruar të termit “prokuror”, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, duke përfshirë në këtë mënyrë ankuesen në rrethin e subjekteve, të cilët, sipas kësaj dispozite duhet të rivlerësohen *ex officio*. Një mënyrë e tillë interpretimi do të prodhonte si pasojë ndalimin e gjendjes së paligjshmërisë së krijuar me emërimin e saj si prokuror, me dekretin nr. 9757, datë 11.10.2016, të Presidentit të Republikës. Kjo mënyrë interpretimi në pajtim me Kushtetutën përmbush edhe qëllimin e reformës në drejtësi për të rikthyer besimin e publikut te një sistem drejtësie ku magjistratët ushtrojnë misionin e dhënies së drejtësisë, pasi të jenë verifikuar në lidhje me integritetin e figurës, ligjshmërinë e pasurisë së tyre dhe profesionalizmin.
10. Për sa më sipër e kam konsideruar të drejtë vendimin nr. 532, datë 18.05.2022, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe kam votuar për lënien e tij në fuqi.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi